


TRIBUNA SINDIKALE

Qershor 2006

Dhe drit' e diturisë
përpara do na shpjerë



Editorial**DRAFTI PER FUNDIMTAR I KONTRATES
SE RE KOLEKTIVE TE PUNES**

Mbas nje pune te gjate dhe intesive prej afro 3 muajsh, ne fillim te muajit qershor, u arrit qe te hartohet drafti perfundimtar i Kontrates se re Kolektive te Punes. Kjo perben nje arritje per sindikatat e arsimit.

Grupet e specialisteve te Ministrise se Arsimit dhe Shkences dhe te te dy Sindikatave te Arsimit perballuan nje vellim te madh pune dhe nje tematike te gjere qe pëmbajne kerkesat dhe interesat sociale dhe ekonomike te sindikalisteve dhe mesuesve e punonjesve te tjere te sistemit parauniversitar te arsimit.

Te dy palet zgjodhen metoden e negociimit me grupe ceshtjesh, gje qe lehtesoi diskutimet, krijoi mundesi per argumentim me te thelle dhe mbeshtetje me te mire ligjore te kerkesave dhe e beri procesin me fleksibel. Sapo specialistet perfundonin nje grup te caktuar ceshtjesh, ne menyre te natyrsme ngrihej niveli i negociimit, duke perfshire drejtues kryesore te MASH deri ne nivelin e Zv/ Ministrit dhe Sekretares se Pergjithshme, nga njera ane dhe drejtuesve kryesore te sindikatave, nga ana tjetere.

Gjate negociimit, grupi perfaqesues i sindikatave kembenguli qe te ruheshin e perfshiheshin ne Kontraten e re Kolektive te Punes arritjet dhe standardet qe pëmbante kontrata e mepareshme kolektive, sidomos ato arritje nga te cilat mesuesit dhe sindikalistet perfitonin shperblime konkrete, sic eshte rasti i pageses deri ne dy paga mujore per mesuesit qe dalin ne pension.

Ne Kontraten e re Kolektive jane plotesuar, saktuar e avancuar shume norma e detyrime reciproke midis punedhenesit dhe punemarresit qe lidhen me kushtet e punesimit, te ndryshimit te vendit te punes, te kushteve te punes, te pagave e shperblimeve.

Ne menyre te vecante, ne kete

kontrate, jane perfshire te drejtat dhe liritet sindikale ne pershtatje me standardet qe pëmbajne Konventat Nderkombetare dhe Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise.

Nenshkrimi zyrtar i Kontrates Kolektive te Punes midis dy paleve do te behet ne ditet e para te muajit korrik.

Por, negociimi dhe nenshkrimi i Kontrates Kolektive te Punes perben per sindikatat e arsimit vetem nje moment, ndonese shume te rendesishem, te veprimitarise se tyre. Kryesorja mbetet zbatimi ne praktike, ne marredheniet e perditshme te punes midis punedhenesit e punemarresit, te dispozitave te kesaj Kontrate. Pervoja e viteve te kaluara dhe ajo e ketij viti shkollor na kane sjelle shume shembuj te moszbatimit te dispozitave te Kontrates Kolektive, madje ne disa raste jami ndodhur edhe para shkeljeve flagrante te saj, gje qe i ka detyruar sindikatat ne qender, por edhe ne mrete, qe te nderhyjne me force ne mbrojtje te sindikalisteve qe ato perfaqesojne.

Zbatimi i Kontrates Kolektive te Punes eshte nje proces. Sukses i ketij procesi varet shume nga kuptimi dhe zbatimi i pëmbajtjes se ketij akti, pra i Kontrates, dhe i gjithje korpusit ligjor te marredhenieve te punes, perfshire konventat nderkombetare, nga nivelet e dyta, konkretisht nga DAR dhe ZA, nga njera ane dhe Seksionet Sindikale nga ana tjetere.

MASH dhe Sindikatat e Arsimit ne Qender do te bejne kujdes qe te organizojne tryeza, seminare dhe ballafaqime ne rrethe per te mundesuar zbatimin e drejte dhe te sakte te dispozitave te kesaj kontrate dhe per te ndihmuar qe palet ne nivelet e dyta te hartojne kontrata sa me konkrete dhe efektive.

Teksti i plote i Kontrates se re Kolektive te Punes do te botohet ne numrin e ardhshem te Revistes "Tribuna Sindikale".

PERMBAJTJA

- ✓ *Editorial:* Drafti perfundimtar i kontrates se re kolektive te punes 2
- ✓ Puna per shmangien e braktisjes se shkolles dhe parandalimin e punes se femijeve nuk mbaron brenda mureve te shkolles 3
- ✓ Te rritet roli i vete grave mesuese, per t'u bere faktor i rendesishem ne sindikate dhe ne arsim 6
- ✓ Arsimimi dhe trajnimi i mesuesve drejt nje zhvillimi profesional afatgjate 7
- ✓ Sistemi aktual i kualifikimit ne Shqiperi, prioritetet dhe sfida 8
- ✓ Arsimi i larte dhe zhvillimet dinamike te tij ne rrafshin e integritit europian 11
- ✓ U mblodh aktivi i SPA Qarkut Tirane 13
- ✓ Kur viti arsimor shkon drejt perfundimit 13
- ✓ Te reja shkencore dhe keshilla praktike 15

Kopertina e pare:

Moment pune ne Shkollen "Pashko Vasa", gjate njerres prej seancave te seminarit per eliminimin e punes se femijeve ne rrethin e Shkodres.

Kopertina e fundit:

Pjesemarreset ne seminarin e grave sindikaliste ne kohen e lire.

TRIBUNA SINDIKALE**Nr. 22, Periodike**

*Botim i FSASH dhe SPASH
ADRESA: Bulevardi "Zogu i Pare"
Pallati Ali Kelmendi, kati III,*

Tel: 22 83 46

Tel & Fax: 25 65 32

E-mail: fsash@icc-al.org

Keshilli Botues:

Xhafer Dobrushaj,

Bajram Kruja,

Lumturi Mataj,

Defrim Spahiu,

Petref Çelaj,

Aleks Dushi,

Stavri Liko, Kryeredaktor

Puna për shmangien e braktisjes së shkollës dhe parandalimin e punës së fëmijëve nuk mbaron brenda mureve të shkollës

Nga Seminari me AOb/FNV për eliminimin e punës së fëmijëve në Shkodër

Ne vazhdim të aktiviteteve për zbatimin e programit me AOb/FNV, dy sindikatave të arsimit, FSASH e SPASH, organizuan në Shkodër seminarin tregues mbi angazhimin e mesuesve për shmangien e braktisjes së shkollës dhe parandalimin e punës së fëmijëve.

Konceptin mbi punën e fëmijëve, shkaqet dhe pasojat, si edhe mbi standardet ndërkombëtare (konventat nr. 138 dhe 182 të ILO) dhe legjislacionin kombëtar për rikrijtjen e fëmijëve dhe eliminimin e punës së fëmijëve.

te tjere duke evidentuar dhe rezultatet e arritura. Dita e pare u mbyll me disa konkluzione rreth punës së bere duke percaktuar detyra per te ardhmen.

Dita e dyte e seminarit ishte akoma me interesante. Ne fillim te gjithë pjesemarrësit u grumbulluan në



Gjate dites se pare, pas paraqitjes se programit dhe te synimeve te keij seminari nga dy drejtuesit e ketyre sindikatave, Z. Xhafer Dobrushii e Bajram Kruja, koordinatori i Programit, Stavri Liko, beri paraqitjen e angazhimit te dy sindikatave te arsimit ne nivel kombetar dhe sidomos ne kater rrethet e fokusuara, (Fier, Elbasan, Tirane (zona e Bathores) dhe Shkoder).

Ne vijim, zonja Shkelqesa Maraj, Drejtore e Njesise per Eliminimin e Punes se Femi jeve prane Ministrise se Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, beri prezantimet mbi

Shpjegimet teorike u shoqeruan me diskutime konkrete, bazuar ne rrethanat dhe problemet qe hasen ne realitetin e shkollave te rrethit te Shkodes.

Duke e konsideruar vijuesmerine e shkollës nga nxënësit si njerin nga problemet me te rendesishem per eleminimin e punës së fëmijëve, mesuesit sindikaliste nga shkollat e ndryshme si dhe perfaqesues te Drejtorise Rajonale te Arsimit, evidentuan shkaqet dhe arsytet e mos vijimit te shkollës nga disa nxenes, metodat e punës për eliminimin e kesaj dukurie, kontributin e sindikatave ne kete drejtim, kordinimi i punës me aktor

Shkollën 9-vjeçare "Pashko Vasa", ku muaren pjese, gjithashtu, edhe drejtoresha e shkollës, si edhe mesues e nxenes te kesaj shkolle, perfaqesues nga drejtoria Arsimore etj. Maren pjese, gjithashtu, edhe perfaqesuesit e Sindikates se Arsimit te Holandes, Z. Marten Kircz dhe Desiree Kootstra.

Drejtoresha e shkollës, Zj. Jolanda Alia dhe Kryetarja e Sindikates se Pavarur te Shkollës, zj. Rajmonda Ieka, informuan mbi gjendjen e braktisjes se shkollës dhe angazhimin e sindikatave e mesuesve per uljen e numrit te ketyre

Puna për shmangien e braktisjes së shkollës dhe parandalimin e punës së femijeve nuk mbaron brenda mureve të shkollës

Vijnë nga faqja 3

nënësve, si kontribut i drejtëpërdrejtë për eliminimin e punës së femijeve. Më tej pjesë në diskutime shumë mesues e nxënës, drejtuesit e sindikatave të arsimit, si edhe përfaqësuesit e AOb.

Mesueset Luigjina Gjeloshi dhe Vera Kadia treguan eksperiencën e tyre me nxënësit e ngujuar për gjakmarrje dhe për arsye të tjera. Prinderit që më tej fjalën treguan se sa e rëndësishme është veprimtaria për të rikthyer një nxënës në shkollë. Aшту siç u shpreh njëri nga prinderit "është njësoj sikur ta kthesh dhe njëherë në jetë". Fëmijet pjesëmarrës shtruan një element shumë të rëndësishëm, ndikimin që ata kanë tek njëri tjetri, mjaftësi që ata duhet të krijojnë duke shmangur pengesat për integritet dhe fëmijëve të ardhur si pasojë e levizjeve të media demografike etj.

Ndoshta së bashku me e rëndësishme ishte ajo e mbasdrekes. Në sallën e Keshillit Bashkiak të qytetit të Shkodrës u organizua një tavolinë e rimbullakimit me pjesëmarrjen e aktoreve me të rëndësishme. Përveç pjesëmarrësve të seminarit, ishin të pranishëm kryetari i Keshillit Bashkiak, z.v. Kryetarja e Bashkisë, drejtori rajonal i arsimit, sekretari i qarkut, sekretari i prefekturës, përfaqësuesi i komisarit të policisë etj. Përfaqësuesit e pushtetit vendor dhe qendror, me gatishmëri të tyre, e kthyen takimin në një forum ku u diskutua rreth shumë problemeve të lidhura drejtëpërdrejtë me vijueshmërinë, por dhe me probleme të tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe përpacimin e arsimit në këto rreth. Ajo që duhet theksuar është se ky takim hodhi ndoshta bazat për funksionimin e një forumi qytetar, të drejtuar nga sindikatat e arsimit, ku të diskutohet rreth të gjitha problemeve me të cilat përballlet sot arsimit shqiptar.

Me shumë interes ishin së bashku e dritës së shtunë. Në fillim, të gjithë

pjesëmarrësit raportuan në lidhje me situatën në shkollat perkatese, bazuar në pyetorin që kishin plotësuar për këto qëllime. Me pas, përfaqësuesja e AOb, Desirée Kootstra, foli për përvojën e saj dhe të AOb për mbrojtjen e të drejtave të femijeve në Holandë. Në vijim pjesëmarrësit bënë propozime në lidhje me një program konkret pune për të ardhmen, ribilazhen e të cilave, zoti Xhafer Dobrushit, paraqiti një projekt me veprimet kryesore që pritet të ndërmëren gjatë këtij viti e në vijim në rrethin e Shkodrës.

NGA DISKUTIMI I DREJTORESHES SË SHKOLLËS Zj. Jolanda ALIA

Shkollat "Pashko Vasa" është një nga shkollat e veshtira në rrethin e Shkodrës e cila frekuentohet kryesisht nga nxënës të familjeve të vendosura në lagjet "Tom Kola", "Skenderbeg" dhe "Fermentim". Shkollat ka gjithsej 685 nxënës, prej të cilëve 312 janë vajza. Në ciklin e ulët janë të regjistruar 283 nxënës, prej të cilëve 136 janë vajza. Në ciklin e lartë janë të regjistruar 402 nxënës, prej të cilëve 176 janë vajza.

Braktisja e shkollës nga nxënësit ka qenë vazhdimisht një problem i rëndësishëm me të cilin jemi marrë, si drejtori dhe si kolektiv mesimor, duke synuar një bashkëpunim edhe me sindikatat dhe me komunitetin. Megjithatë ky problem akoma nuk është kapërcyer edhe për shkak të veshtiresive që ekzistojnë në këto zona. Aktualisht shkollat tona e kanë braktisur 17 nxënës, prej të cilëve 9 janë vajza. Si rezultat i punës së bërë, vetëm gjatë këtij viti janë kthyer në shkollë 4 nxënës që e kishin braktisur atë dhe në jemi në vazhdim të një pune konkrete për të bërë të mundur kthimin në shkollë edhe të nxënësve të tjerë që e kanë braktisur atë.

Karakteristike është që braktisjet e

shkollës, ose vijimi me hope vihen në sidomos nga radhët e nxënësve të familjeve që kanë ardhur në këto lagje pas viteve '90.

Në shkaqet kryesore që çojnë në largimin e nxënësve nga shkollat janë rënia e interesit të prindërve dhe ndikimi i tyre të fëmijet e vete për t'u larguar nga shkollat për arsye të ndryshme. Vihet re se në ciklin e ulët të gjithë prinderit janë të kujdesshëm me fëmijet e tyre, ka një marrënie të mirë dhe të afert mesues - nxënës - prinder. Por ky interesim nuk vazhdon për nxënësit e klasave të larta dhe si rrjedhojë, nxënësit fillojnë gradisht të largohen nga klasat, në fillim në orë dhe pastaj me ditë të tera deri në largimin përfundimtar. Shkaqet ekonomike kanë, gjithashtu, një ndikim të ndjeshëm në largimin e nxënësve të shkollës sone nga detyrimi shkollor. Në shumë raste këta nxënës që braktisin shkollën fillojnë të punojnë së bashku me prinderit e tyre, por ka prej tyre që fillojnë të punojnë edhe vetëm. Edhe mentaliteti dhe niveli i ulët kulturor i prindërve ka një ndikim të ndjeshëm tek fëmijet e tyre. Disa nga prinderit justifikohen se fëmijet e tyre, sidomos vajzat, janë rritur, s'ka ç'u duhet shkollat dhe se janë me të sigurt në shtëpi. Ndikim në largimet nga shkollat ka edhe fenomeni i gjakmarrjes, bazuar në Kanun, duke e shtrembëruar edhe vete Kanunin, i cili nuk e parashikon ngujimin e fëmijëve.

Për zbutjen e këtij fenomeni në shkollat tona janë angazhuar, përveç mesuesve të shkollës, edhe inspektorët të Drejtorisë Arsimore, përfaqësues të Kryqit të Kuq e të Organizatave të tjera jofitimprurëse, të angazhuara për eliminimin e punës së femijeve etj. Me efektivitet ka qenë edhe angazhimi i organeve të pushtetit vendor, sidomos në drejtim të zbatimit të ligjeve që kanë të bëjnë me këto çështje.

Në, nga ana jone, do të vazhdojmë

te bashkëpunojme me prinderit dhe te gjithë faktoret e interesuar, duke përfshirë edhe vete nxenesit, me qëllim që ky fenomen të shkojë drejt zbutjes dhe eliminimit gradual.

NGA DISKUTIMI I KRYETARES SE SINDIKATES SE PAVARUR TE SHKOLLES

Zj. Raimonda LEKA

Me gjithë veshtiresite që hasen, në shkollën tonë ka shumë shembuj pozitivë në lidhje me trajtimin e vecante të disa nxenesve që kanë reflektuar probleme në drejtim të vijueshmërisë së rregullt ose largimeve nga shkolla.

Në vijim janë disa shembuj shumë

edhe ringjallja e gjakmarrjes, gjë që ka ngujuar edhe femijë. Me ndihmën e një shoqate, disave prej tyre u bëhet mesim nga mesuesja e shkollës sone, me lejen e MASH. Keshtu nxenesit Jurgen Kosova, Ornela Kosova ndjekin rregullisht mesimet, ndërsa nxenesi Anton Hila vjen në shkollë herë pas here.

Nuk mund të lenë menjëherë edhe mentalitetin e vjetër të disa prindërve për "ruajtjen" e vëzhgimit fizikisht. E ndikuar nga opinioni shqetësues dhe sidomos nga opinioni i fisit, disa prindër i largojnë nga shkolla vajzat, siç ishte rasti me nxeneset Luljeta Rama dhe Anila Hila. I është dashur

ata pas dore, nuk u kërkojnë llogari, duke konsideruar se e kanë miratuar detyrimin si prind vetëm duke i veshur e ushqyer mirë, ndonjëherë edhe duke u dhënë para me bollëk. I tillë është rasti i nxenesit Elvis Peqa, i cili e ndjek vetën të lirë nga njëra anë dhe braktis mesimin duke mashtruar edhe mesuesin dhe prindin. Me takime të shpeshta me prindin, u arrit të krijohet bindja se me një qëndrim të tillë, femija do të ishte gjysmë, prandaj aktualisht prindi në fjalë është tani shumë aktiv, duke e ndjekur femijen e vete në shkollë e në ambiente të tjera.

Ndërkohe duhet të pranojmë se jo gjithmonë kemi qenë të suksesshëm. Kemi akoma nxenes të larguar nga shkolla ose të tjerë që i ndjekin mesimet me hope, herë vijne herë mungojnë. Nuk mungojnë edhe rastet ekstreme. Keshtu psh nxenesi Grasiel Nika nuk e gëzon kujdesin e duhur prindëror, për shkak të ndryshme. Në keto kushte, deri në klasën e gjashtë femija e ndoqi rregullisht shkollën, por me vonë, duke patur disnivël moshe, atë e terhoqi shqetësimi jashtë shkollës. Atij i dëhët të vishej në ndryshje, të kishte edhe një celular, duke u angazhuar edhe në një punë sezonale. Në keto kushte na u desh që të benim një punë të vecante me të gjatë semestrit të parë, duke u përparë që ta kthejmë në shkollë, gjë që dha rezultatet e veta. Me mirë vepruan edhe mesuesit e tjerë që i jepnin mesim, duke u përparë që ta miratnin afër. Jemi duke e vazhduar punën me të, megjithatë akoma nuk kemi arritur që ta terhoqim plotësisht në klasë e në shkollë.

Eshtë e qartë që puna për shmangien e braktisjes së shkollës dhe parandalimin e punës së femijëve nuk miratohet brenda mureve të shkollës, por ajo është një detyrë e të gjithëve, e çdo institucioni, përfshirë shkollën dhe pushtetin lokal, si edhe organizatat e ndryshme, pa përjashtuar vete nxenesit që kanë një rol të pazevendesueshëm, përse i perket ndikimit tek shokët e tyre të klasës ose shkollës.

Pergatiten:
Aleks Dushi
Stavri Liko



kuptimplote në lidhje me konkluzionin se kur punohet konkretisht, rezultatet nuk mungojnë.

Pas mbylljes së shumë shkollave, në vitet 1990-1995, shumë prindër kanë insistuar që t'i sjellin femijet në shkollën tonë, për të filluar klasën e parë dhe për të vazhduar këtë rregullisht. Duke patur parasysh nevojën që kanë këta femijë për integrimin e tyre në qytet, për ruajtjen e ekuilibrit në lidhje me diferencat e moshës, si edhe për realizimin e të mesuarit sipas programeve mesimore, mesuesja, jo vetëm që i ka pranuar këta femijë, por edhe ka bërë një punë të vecante me ta. Si rrjedhojë, sot nxenesit Mondi Preci dhe Gjon e Shuk Bishaj vazhdojnë rregullisht mesimet në klasën e shtatë.

Një problem mjaft shqetësues është

një punë e madhe bindese mesueses që të bëjë të mundur kthimin e nxeneses në shkollë. Ajo sot ndihet e kënaqur që është rikthyer në shkollë, duke provuar një trajtim shumë miqësor si nga mesuesit, ashtu edhe nga vete nxenesit e klasës dhe shkollës.

Në shkollën tonë ka mesues me përvojë e nivel edhe nga ana profesionale.

Sindikata e shkollës bën të gjitha përpjekjet që mesuesit të angazhohen edhe në një punë konkrete me nxenesit dhe prinderit e tyre, të cilët nuk hezitojnë të përdorin edhe forcën, madje edhe dhunën për t'i detyruar femijet që të veprojnë sipas "keshillave" të prindërve, për t'u larguar nga shkolla. Disa prindër rëndin pas punës dhe i harrojnë femijet për të cilët punojnë aq shumë, i lenë

TE RREDITET ROLI I VETE GRAVE MESUESE, PER T'U BERE FAKTOR I RENDESHISEM NE SINDIKATE DHE NE ARSIM

Nga seminari me AOb/FNM rreth punes me grate drejtuese lokale ne sindikate

Pas seminarit te vitit te kaluar dhe pas nje pune konkrete ne rreth 15 rrethe te vendit, keto dite u organizua ne Tirane seminari treditore per punen me grate mesuese ne sindikate.

Me prezencen e 27 grave drejtuese te organeve lokale te FSASH dhe SPASH, ne rrethe, ne seminar u trajtuan disa tema trajnuese dhe u diskutuan probleme te shumta qe kane te bejne me situaten aktuale, si edhe me rolin e grave si mesuese, si anetare te sindikatave dhe si drejtuese ne organet arsimore e ne sindikate.

Ne ditet e pare seminari u konceptua ne formen e disa workshopeve ku u diskutuan ceshtje te rendesishme te punes me grate duke filluar qe nga legjislatiioni kombetar, politikat sindikale rreth rolin e grave ne sindikate, puna per organizimin e grupeve (komisioneve) te grave prane seksioneve sindikale te rretheve, perfshirjen e ketij problemi ne kontraten kolektive te punes etj.

Gjate kesaj pune grate drejtuese lokale pjesemarrrese ne seminar u ndihmuan nga afer prej lektoreve dhe drejtueseve te grupeve te grave prane FSASH e SPASH, Fatbardha Keço, Lunturi Mataj, Reihan Shkreta dhe Bukuroshe Shabani.

Ne dy ditet ne vijim dy lektoret holandeze Trudy Kerperien dhe Claire Oostriesland perdoren metoda shume interesante interaktive, duke synuar perfshirjen e te gjitha grave pjesemarrrese ne diskutimin e problemeve dhe duke vene theksin tek roli i vete grave per mritjen e rolit te tyre ne sindikate.

Shume aktive ishin ne seminar perfaqesueset e FSASH e SPASH Violeta Paço, Blerina Lala, Margarita Koroveshi, Luljeta Jakupi, Dava Dedaj, Valbona Duçi, Donika Coli, Lunturi Kariqi, Sofika Prifti etj, te cilat jovehan

moren pjese gjallerisht ne diskutime ne seancat plenare e ne punen ne grupe, por edhe raportuan e shpjeguan konkluzionet e arritura gjate punes ne grupe.

Metodika e seminarit ishte nje gershetim i shpjegimeve teorike, me shqyrtimin e situates aktuale, evidentimin e prioriteteve dhe përpilimin e planeve te veprimt per te ardhmen.

Nje vend te rendesishem zuri njohja

- Përpquni te jeni te kendeshme dhe miqesore me te gjitha ata qe punoni, per te mos i merzitur dhe per t'i terhequr ne iniciativat qe ndemmermi,

- Mesoni si te organizoni sindikaten, kerkoni gjithnje strategjite me te mira, siguroni nbeshtetje sa me te gjere brenda dhe jashte kolektivave tuaja. Po te jeni te bashkuara do t'ju duhen me pak kohe e para per te realizuar synimet tuaja,



ne pervojat holandeze, paraqitur me shume kujdes nga lektoret holandeze Trudy Kerperien dhe Claire Oostriesland te cilat shpjeguan jovehan historikun e zhvillimeve dhe ndryshimeve te medha ne lidhje me rolin e gruas ne shoqeri e ne sindikate ne Holande, duke filluar qe nga vitet '70, por njekohesisht dhane disa keshilla shume praktike per domosdosmerine e angazhimit te vete grave per realizimin e synimeve te tyre.

Disa nga keto keshilla jane:

- Behuni te dukeshme, nepemnjat aktivitetet te ndryshme, duke treguar se jeni te pranishme si mesuese dhe si sindikaliste,

- Tregohuni se keni mendimet tuaja per ceshtjet qe ju perkasin, por edhe per te tjerat ne skolle e jashte saj,

- Si te gjitha gjerat e tjera edhe pemi-resint qe ju synoni te realizoni duan kohe, prandaj, mos u merzitni dhe asnjehere mos u terhigoni, jini kembengulese per ato qe kerkoni te realizoni, sepse rezultatet nuk do te mungojne.

Moment shume i rendesishem i ketij seminari ishte percaktimi i prioriteteve te dy sindikatave tora te arsimit per punen me grate mesuese, nder me kryesoret e te cilave u evidentuan:

- Njohja me e mire dhe propozimi i ndryshimeve te nevojeshme ne legjislatiionin rreth pozitën e gruas ne tregun e punes, si edhe reflektimi ne Kontraten Kolektive te punes dhe ne Statusin e Mesuesit, ne lidhje me pemi-resimin e pozitës se grave mesuese ne sistemin arsimor dhe ne

sindikate.

- Konsolidimi i grupeve (komisioneve) te grave dhe mbështetja e tyre nga organet qendrore e lokale te te dy sindikatave, me synim organizimin e nje pune te vecante me grate mesuese per mritjen e nimit te tyre ne sindikate dhe ne organet drejtuese te tyre dhe te administratave te shkollave.

- Trajnimi i grave drejtuese te grupeve (komisioneve) dhe deri i grave sindikaliste te thjeshta brenda nje kohe te shkurter, me qellim qe edhe pemiresint e para te fillojne te duken, duke sherbyer si nje baze e mire per vazhdimin e metejsme te kesaj pune.

- Pasqyrimi dhe propagandimi i punes se grave mesuese dhe aktivitetit

te grupeve te grave ne Revisten "Tribuna Sindikale".

Jo vetem ne seancat e seimnarit, por edhe ne pushime e ne kohet e lire, grate pjesemarrjes bene diskutime te shurta per problemet e arsimit ne teresi, si edhe per angazhimin e grave mesuese ne sindikata.

Fatbardha KEÇO

Arsimimi dhe trajnimi i mesuesve drejt nje zhvillimi profesional afatgjate

Nga Konferenca Kombetare, Korçe

Ministria e Arsimit dhe Shkences, Qendra e Trajnimit dhe Kualifikimit per Arsimin, (QIKA), me mbështetjen e Bankes Boterore, organizuan ne Korçe, ne sallën e Bibliotekes se qytetit, Konferencen Kombetare me teme: "Arsimimi dhe trajnimi i mesuesve drejt nje zhvillimi profesional afatgjate".

Ne kete konference moren pjese Ministri i Arsimit dhe Shkences, z. Genc Pollo, zv. ministri z. Halit Shamata, specialiste te QIKA-se, perfaqesues te BB, te sindikatave, drejtues dhe specialiste te DAR-ve dhe ZA-ve, perfaqesues nga pushteti vendor, universitetet rajonale, si dhe te QJF-ve.

Fjalën e hapjes ne kete konference e mbajti zv. ministri i Arsimit dhe Shkences, z. Halit Shamata, i cili vleresoi rendesine e punimeve te saj ne stadin aktual te zberthimit konkret te politikave arsimore ne sferen e arsimit dhe pjesemarrjen ne te te shume aktoreve qe do te bejne te mundur realizimin e tyre.

Ministri i Arsimit dhe Shkences, z. Genc Pollo, pershendeti Konferencen Kombetare dhe theksoi domosdoshmerine e organizimit te ketij procesi qe do te kualifikoje mesuesit ne shkalle kombetare per te qene ne nivelin e standardeve te kerkuara te dhenies se mesimit, per mritjen e cilesise se shkolles sone te reformuar.

"Kemi nevojë per te arritur ne kete qartesi raportesh dhe hierarkie edhe per nje sistem te qarte pergjegjesish, - tha gjate takimit Ministri, - me nje strukture, gjithashtu, te qarte qe organizon ne shkalle kombetare kualifikimet e mesuesve. Kemi nevojë per nje rrjet trainersh te certifikuar, mesuesish me

kompetenca te qarta dhe te pakontestueshme, qe te shërbejë si nje shtyllë kurrizore vepruese e sistemit te trainimeve, te ciles ne menyre periodike do t'i nenshtrohen te gjithë mesuesit.

Jemi mbledhur ne kete Konference Kombetare, ne Korçen e Shkolles se Pare Shqipe, edhe per te konceptuar nje sistem kualifikimesh, i cili ecen gradualisht dhe ka shkallezimin e tij te natyrshem ne menyre qe te jete edhe nje rritje e stimulues i merites dhe i dhenies se mesimit sipas cilesise qe kerkon koha."

Ne emer te sindikatave te arsimit Konferencen e pershendeti Kryetari i FSASH, Prof. As. Dr. Xhafer Dobrush. Moasi vuri ne dukje se trajnimi i mesuesve eshte nje nga sfidat me te forta per te perballuar kerkesat e reformimit dhe modernizimit te arsimit ne vendin tone, ai u ndal vecanerisht ne rolin dhe vizionin e sindikatave te arsimit per trajnimin e mesuesve. Sindikatat e Arsimit, FSASH dhe SPASH, theksoi z. Dobrush, prej me shume se 6 vjetesh e kane kapercyer fazen e njeaneshmerise ne veprimtarine e tyre. Krahas parashtrimit, argumentimit dhe mbrojtjes se kerkesave dhe interesave sociale ekonomike te mesuesve, ato, sindikatat, po merren me efektivisht me problematiken thelbesore qe percakton suksesin e reformimit dhe modernizimit te arsimit. Ne kete problematike vend qendror ze edhe trajnimi i mesuesve, qe tasme edhe me ndihmen e Federates Boterore te Arsimit EI, Sindikates Holandeze te arsimit AOb, etj, ka marre permasa te gjera, zhvillohet ne menyre sistematike dhe ka fituar qendrushmeri.

Ne pamje te jashtme te krijohet pershtypja se sindikatat bejne me mesuesit anetare te tyre vetem trajnim sindikal. Sigurisht qe trajnimi qe ato bejne eshte edhe sindikal. Por ai eshte i harmonizuar mire me trajnimin profesional ne nivelin e kerkesave te kohes. Ne seminarin treditore qe organizohen me mesues e drejtues sindikaliste, me gra sindikaliste dhe mesues te rinj, krahas njehurive sindikale trajtohen edhe tema baze te Strategjise se Arsimit, sic jane kurrikulat, metodat e mesindhenies, sistemi i vleresimit te punes se mesuesit, te mesuarit gjate gjithë jetes, puna me mesuesit, etj. Pozitiv eshte fakti se te gjitha keto tema zhvillohen nga lektore sindikaliste te afte jo vetem te huaj, por edhe shqiptare, qe jane pergatitur me trajnime te gjata brenda e jashte vendit.

Pastaj Konferenca vazhdoi punimet ne seanca te vecanta sipas problematikave te percaktuara.

Synimi i kesaj konference ishte zhvillimi dhe implementimi i nje sistemi te ri dhe progresiv per aftesimin profesional te mesuesve, i cili gjithnje e me shume po shihet si nje proces qe zgjat, i hapur per vleresim dhe vetvleresim dhe qe ka per synim vetaktualizimin e plote profesional.

Nga kjo konference pritet te rriten disa aspekte te vendimarrjes. Qeveria shqiptare ne baze edhe te Strategjise per Arsimin Parauniversitar 2005- 2015 dhe programit te Bankes Boterore "Cilesi dhe barazi ne arsim", do te marre nje sere vendimesh qe kane te bejne me trajnimin e vazhdueshem dhe cilesor te mesuesve per disa zgjidhje sistematike me shkallet e kualifikimit te tyre.

SISTEMI AKTUAL I KUALIFIKIMIT NE SHQIPERI, PRIORITETE DHE SFIDA

Nga referati i mbajtur ne Konferencen Kombetare te Kualifikimit

Ilia Paluka, MASH

Zhvillimi ekonomik dhe social i nje vendi varet nga zhvillimi i burimeve njerezore te miredukara dhe kualifikuara dhe kjo realizohet pames nje sistemi efektiv arsimor qe ka mesues dhe administratore shkollore te trajnuar, por edhe ne proces te vazhdueshm trajnimit, duke siguruar dhe ruajtur cilesi bashkechore te nivelit te tyre.

Kualifikimi i mesuesve eshte nje faktor i pandare nga te gjitha strategjite e zhvillimit te nje vendi, sepse zhvillimi i sistemit arsimor i mbeshtetur ne strategjite qeveritare, zbatohet nga mesuesit e pedagoget, te cilet kane nevojte per nje trajnim te detajuar dhe te lamishem.

Çdo politike kualifikimi mbeshtetet mbi nje analize te programit te ndjekur me pare, nga ku dalin rezultatet, efektiviteti e metodave dhe formave te perdorura dhe gjenden format dhe metodat e reja te kualifikimit, ne perputhje me ndryshimet e reja.

Situata ekonomike e vendit, procesi i tejzgjatur dhe jo i miremenaxhuar i tranzicionit kane patur ndikime negativ ne zhvillimet arsimore te vendit pames:

- 1) rënies së regjistrimeve ne shkollat qe pergatisin mesues;
- 2) mosperputhjet ne zhvillimin urban dhe ate rural;
- 3) migracionit brenda vendit nga zonat rurale ne ato urbane;
- 4) statusit te ulet te mesuesve;
- 5) mjediset e jo te pershtatshme te mesimdhënies;
- 6) mosperputhjes me nevojat e zhvillimit te ekonomise te tregut etj.

Ne strategjine afatmesme te MASH-it thuhet: "Situata ne arsimin parauniversitar eshte ende e panormalizuar". Kjo eshte nje arsye qe MASH duhet t'i kushtoje prioritet normalizimit te sistemit arsimor, te nise eficiencyn e tij, dhe te ngreje me lart cilesine ne procesin e mesimdhënies dhe te nxënies. Mesuesit jane ne qender te ketyre qeshtjeve baze.

Fakti qe vendi yne eshte duke kaluar nje proces reformash ne kuadrin e anetaresimit ne Bashkimin Evropian dhe

ne struktura te tjera nderkombetare, si rezultat i zhvillimit tekniko-shkencor te mijevjeçarit te ri, ben qe procesi i reformimit te sistemit arsimor dhe kryesisht mritja e cilesise se mesimdhënies te jene te pashmangshme per te siguruar sherbime efektive ne arsim dhe ne ristrukturimin te tij, kryesisht ne arsimin parauniversitar.

Per t'i zhvilluar burimet njerezore, eshte mese e natyrishtme te njihet situata, te studichet niveli i gjendjes se mesuesve dhe mbi kete baze te krijohen vizione, te gjenden dhe te ndertohen strategji sa me efektive per avancimin e arrijteve te te gjitha personelit arsimor dhe posaçerisht te atyre te niveleve te ulta qe sot jane te pranishme ne shkollen shqiptare.

Ndryshimet e kurrikulit te shkolles ne te gjitha nivelet e shkollimit ribetet nje perparesi e programit te Qeverise. Keto ndryshime do te mundesojne peraftrimin e shkolles shqiptare me standardet evropiane. "... Qe mesuesit t'u pergjigjen ketyre ndryshimeve, duhet te kualifikohen, duhet trajnim i vazhdueshm i tyre per te ndryshuar konceptet e mendesite."

Per te pergatitur nje strategji apo kuader te ri te kualifikimit duhet mbajtur parasysh se kualifikimi eshte zhvilluar i mbeshtetur ne keto forma:

Format e kualifikimit te perdorura:
1 Kualifikimi institucional (qendror dhe lokal):

- Kualifikim i cili nuk mbeshtet mbi oferte-kerkese, por ne nje sistem te paracaktuar.

- Kualifikim i cili nuk ve ne qender mesuesin dhe nevojten e tij konkrete per zhvillim profesional, sepse mungojne standardet dhe kerkesat per kete zhvillim.

- Kualifikim i cili nuk merr parasysh balancen administrative inspektor - drejtor shkolle - mesues, sepse kjo nuk ekziston;

2 Kualifikimi ne mbeshtetje nga QJF, fondacione dhe organizata te ndryshme vendase dhe te huaja karakterizohet nga:

- mungesa e nje strategjie te qarte institucionale çon drejt pranimit te ofertave dhe nevojave te çastit,

- mungesa e lidhjes midis kualifikimeve dhe interesave te

institucioneve,

- mungesa e evidencave per zhvillimin profesional konkret apo nevojta e mesuesve per zhvillim.

3 Kualifikim individual.

-Mungesa e sistemit te certifikimit dhe te akreditimit te kualifikimeve e ben kete forme te rendesishme kualifikimi inegzistente, te pamotivuar, te pavleresuar, jo te rregullte.

Pas vitit 1992 pati nje ndryshim edhe ne kete fushë. Hapja e vendit solli dhe krijimin dhe mundesine per te patur me shume mundesi per konsulencia e materiale te ndryshme. Por kjo periudhe u perballll edhe me nje problematike komplekse, e cila kryesisht u shpreh ne rënien e numrit te mesuesve te kualifikuar. Nga viti 1992 deri ne 1998 rezultoi se 22% e mesuesve ishin te pakualifikuar dhe ne disa raste ne arsimin 8-vjeçar kjo shifer arrinte ne 33%. Ne vitin shkollor 1998-99, sipas statistikave, rezultonte se 90% e mesuesve te parashkollorit, 50% e mesuesve te arsimit 8-vjeçar dhe 4.3% e mesuesve te shkollave te mesme ishin pa arsimin perkates.

Diferenca te theksuara viheshin ne ne kualifikimet urbane dhe rurale. Ne vitin shkollor 1997-98 u kualifikuan 73% e mesuesve e shkollave urbane, ndersa vetem 44 % e mesuesve te shkollave rurale ishin te kualifikuar.

Prezantimi i teknikave te reja. Nje e tille ishte "te mesuarit me objektiva" e paraqitur ne vitin 1992-93. Ajo u trajtua si nje forme e re kualifikimi, por pavaresisht rrisive qe solli, nuk pati ndikim te fuqishm ne permiresimin e cilesise te mesimdhënies.

Mesuesit vazhdonin te ishin tradicionale dhe rezistente ndaj teknikave novatore.

Kualifikimet vjetore u pane si nje organizimi ri ne kuadrin e decentralizimit. DA-te u ngarkuan te realizonin kete kualifikim ne bashkepunim me ISP-ne. Por duke mos patur statusin dhe strukturen, si dhe mungesen e programeve, nuk siguruan vazhdimesi.

Kualifikimi pames projekteve: Kualifikimi ne kete periudhe u inkuadrua edhe ne programet e projekteve te

organizuata nga QJF dhe fondacione. Ky tip kualifikimi u duk si nje mbeshtetje e madhe per sistemin ne ate kohe, por mesuesit nuk arrinin te shikonin zhvillimin e tyre profesional, per shkak te menyres se percaktimit te tipit te trajnimit dhe perberjes se grupeve.

U shfaq nje dukuri, perfitimi financiar nga pjesemarrja ne trajnim. Motivimi financiar po sfidonte ate profesional. Raporti kerkese - oferte u pambys, duke denuar te ardhmen e kualifikimit dhe kryesisht ate qe eshte me kryesorja: kerkesen e mesuesve per kualifikim dhe zhvillim profesional.

te integruar forcat ne nje rrjedhe te perbashket kualifikimi;

- literatura e pergatitur ne mbeshtetje te arsimit pati nje ndikim te vogel ne permiresimin e teknikave te mesimdhënies/nxënies. Ende nga inspektorët e bera vihen re mangësi ne nxënie, cilesi jo te kerageshme, per pasojë, arsim jokonkurren.

Kualifikimi ne periudhen 2000 - 2005 ka pesuar ndryshime ndoshta me shume ne strukture se sa ne thello dhe serish ka te meta qe lidhen me organizimin dhe pambushjen e detyrimeve.

Trajnimi i mesuesve ne sherbim pesoi

Prioritetet e reformimit te sistemit te kualifikimit .

Reforma ne arsim varet nga struktura e qarte, zbatimi i saj ne praktike dhe kualifikimi i burimeve njerezore.

Kualifikimi eshte prioriteti kryesor ne parapergatitje dhe ne procesin e punes te mesuesve.

Kjo reforme fillon nga:

- krijimi i strukturave (qendrore, lokale) dhe i infrastrukturave kualifikuese (qendrat e trajnimit te mesuesve);
- hartimi i kuadrit te kualifikimit;
- hartimi i programeve kualifikuese;
- certifikimi/akreditimi.



Kualifikimi i zhvilluar nga QJF ka patur edhe mangësi si:

- mungese dokumentesh per te provuar efektivitetin e punes disarjeçare te zhvilluar prej tyre;

- perqasje josistematike te qeshtjeve te lidhur ngushte me cilesine ne mesimdhënie, nevojat e trajnimit dhe pambajtjen e trajnimit;

- trajnues shpesh pa kualifikimin e duhur dhe pervojën e kerkuar per te realizuar keto trajnime;

- shtrirje zonale e projekteve jo ne menyre te rregullt apo te nje planifikimi;

- financimi ne varesi te donacioneve dhe kualifikimet mund te rnderpriteshin;

- nuk kishte strategji institucionale per

ndryshime, sidomos me riorganizimet e bera ne MASH dhe institucionet vartese, por edhe me ndryshimin ne strukturen e arsimit te detyruar. Sipas legjislacionit ne fuqi, institucionet qe pergjigjen per organizimin e kualifikimit te mesuesve jane DAR-et dhe ZA-te.

Kualifikimi ne kete periudhe i kaloi Drejtorive Arsimore Rajonale te cilat krijuan dhe vune ne funksion sektoret e kualifikimit.

Ky sistem synoi fuqizimin e DA-se duke futur ne sherbimin e trajnuesit inspektorët e DA-se. Veprimtarite e perbashketa te DAR-eve dhe institucioneve qendrore te trajnimit dhe te kualifikimit perfshijne nje numer te vogel mesuesish.

Ristrukturimi i MASH-it dhe institucioneve vartese te saj synoi krijimin e strukturave qe do te menaxhonin, analizonin dhe jepnin rekomandime per permiresimin e sistemit te kualifikimit si pjese e strategjise se arsimit. Ne kete kuader jane hartuar udhezime per percaktimin e roleve dhe pergjegjesive te stafit te Qendres ne lidhje me grupet e interesit ne nivel rajonal dhe lokal. Puna vazhdoi per zbatimin e tyre konkret ne teren, por strukturat nuk funksionuan si duhet sepse:

- pershkrimet e punes ishin te pergjithshme;

- munguan kualifikimet e duhura per

SISTEMI AKTUAL I KUALIFIKIMIT NE SHQIPERI, PRIORITETE DHE SFIDA

Vijn nga faqja 9

keto struktura;

- u mbivendosen detyrat per institucione te ndryshme;

- mungoi bashkepunimi midis drejtorive ne MASH-it;

- misionet e here pas hershme te Bankes Boterore dhe asistenteve te huaj kane mbetur vetem ne orientime pa dhene zgjidhje konkrete.

Ne vitin 2005 u krijua edhe Qendra e Trajnimit dhe Kualifikimit per Arsimin. VKM per krijimin e QIKA-se, mori shkak nder te tjera edhe nga:

- mungesa e standardeve te mesuesve,

- mungesa e kualifikimeve te tyre,
- mungesa e moduleve te kualifikimit,
- mungesa e vleresimit te arritjeve,

Po punohet qe sherbimet aktuale qe ofron kjo Qender te dokumentohen dhe te behen publike.

Temat e reja te referencas per stafin dhe rekrutimin e stafit do te programohen dhe do te formulohen nbi bazen e merites.

Vepriarite e kualifikimit te mesuesve ne proces pune nga MASH planifikohen ne dy dimensione, ne ate qendror dhe lokal. Secili dimension mbeshtetet ne strategjine e pergjithshme.

Ne perputhje me ligjin dhe akte te tjera rregulluese te hartuara nga MASH, per te mbeshtetur reformen pergatiten programet e trajnimit, kerkesat dhe certifikimi i mesuesve, qe sipas studimit te nevojave mund te ndahen ne

1 Trajnime afatgjata . Ky tip kualifikimi perfshin studimet pasuniversitare.

2 Trajnime afatshkurtra , ku perfshihen trajnimet me periudha te caktuara te nisura sipas nevojës se kualifikimit te mesuesve. Keto mbeshteten nbi module te veçanta dhe ne fund mesuesi merr certifikate ndjekjeje. Nese mesuesi ndjek nje kurs te plote te ketyre kualifikimeve, ai merr certifikate zhvillimi profesional. Nje modul afatshkurter mund te përbaje minimalisht 25 ore trajnimi qe te pajiset me certifikate.

3 Trajnimet sezonale , ku perfshihen trajnimet verore, dimerore apo te pershtatura; pergjithesisht ofrohen nga shoqata joqeveritare si shoqatat e mesuesve apo organizma te huaja, te cilat i organizojne posaçerisht per mesues dhe

nevoja te ndryshme. Keto programe, sipas certifikimit, akreditohen nga komisioni perkates.

Nevoja per prezantimin e modeleve te reja per trajnimin e mesuesve

Ne Strategjine e Arsimit thuhet se "Pervec skemes baze te trajnimit, QIKA duhet te shqyrtojte modele alternative per sigurimin e trajnimit te mesuesve si: modele per trajnimin e mesuesve ne klasa kolektive, modelin e trajnimit te mesuesve te klasave te caktuara, modelin e trajnimit te mesuesve te lendeve te veçanta, modelin hibrid, mesimin frontal dhe mesimin ne distance. Per kete qellim do te zbatohen modelet e reja dhe alternative te trajnimit te mesuesve, te cilat zgjerojne kompetencat e mesuesve per rritjen e efektivitetit te shkolles, afrimin e raportit mesues-nxenes me mesataren nderkombetare dhe rritjen e efiqences se sistemit arsimor".

Krahës modeleve te trajnimit ka lindur nevoja per "Programet e certifikimit", qe gjithashtu jane te lidhura me prioritetet per trajnim te mesuesve ne perputhje me zhvillimin dhe reformen. Programet e certifikimit ndjekin forma te ndryshme ne varesi te strategjise se pergjithshme. Ato mund te prioritarizohen ne baze te cikleve, lendeve apo kategorizimit te mesuesve (me diplome, pa diplome).

Programet e certifikimit variojne. Nese institucioni qendror mendon se u arrit nje rezultat, ai e nderpret programin, por mund edhe te vazhdoje programe te tjera per te cilat nuk eshte i kenaqur. Certifikimi, si mjet qe tregon pëmbushje/perfundim, i jepet mesuesit apo te interesuarit i bazuar nbi programin e certifikimit. Certifikatat jane disa llojesh : certifikata pjesemarrjeje, certifikata per plotesim kursi etj. Akreditimi lind si menyre per sigurimin e cilesise te mesimdhënies. Ai lind si nevojë qe çdo mesues i perfshire ne mesimdhënie duhet patjetër te kete nje njohje te certifikimeve te tij. Kete shërbim e siguron nje komision i veçante i quajtur Komisioni i Certifikimit dhe i Akreditimit ose KKIM qe eshte pergjegjes per modalitetet e kualifikimit.

1. Trajnimi i mesuesve me diplome te ndare ne cikle - CF, CMU, CML, CMP. Bazuar ne nevojat e çdo cikli dhe ato te mesuesve trajnimi mund te ndahet ne: i

pergjithshem apo baze, i avancuar , profesional.

2. Trajnimi i mesuesve pa diplome. Per kete kategori kualifikimi ka menyra te ndryshme. Përpara ose gjate punesimit te nje mesuesi pa diplome ne arsim, per kualifikimin mund te ndiqet kjo linje:

a) Pergatitet nje kurs njevjeçar , 3 dite ne jave ne universitete per dhenien e njohurive me te domosdoshme ne nje kohe te caktuar dhe perfundon me certifikim, i cili perackton se njohurite jane te vlefshme per nje cikël te caktuar shkollor .

b) Pergatitet nje modul prej 100 ore per te dhene teknikat e mesimdhënies dhe ne fund certifikohen. Dy certifikatat akreditohen dhe mesuesi merr nje diplome per nje cikël te caktuar .

Hartimi i treguesve per trajnimin e mesuesve .

Pergatitja e ketyre treguesve ndihmon ne sigurimin e disa shërbimeve si:

- peracktimin e politikave te trainimit te mesuesve,
- trajnimin e mesuesve para emerimit ne pune,
- kriteret e emerimit te mesuesve,
- kriteret e vleresimit te punes se mesuesit,
- normat e trajnimit individual te mesuesit,
- trajnimi i rregullt i mesuesve nga shteti,
- numri i nxenesve per çdo mesues dhe norma mesimore.

Sfidat per mesuesit :

Bazuar ne politiken se kushdo ka te drejte te arsimohet dhe te kerkoje kualifikim, MASH dhe QIKA te filloje nje praktike te re mbeshtetur nbi menytrat se si do te ofroje kualifikimin per mesuesit. Eshte e pamundur te mundesosh kualifikime per grupe te medha duke patur parasysh edhe shkeputjen nga shkollla. Per kete zgjidhen tregues per te kategorizuar kualifikimin si:

Format dhe koha e emerimit dhe nomimit te punes se mesuesit kur , për arsye te ndryshme, kemi mesues me norma te plota dhe te reduktuar . Ka prioritet ai ne ngarkese te plote.

Tregues te punes se tij, kjo per te krijuar balance te drejte per shpërndarjen

Vijn në fagen 11

ARSIMI I LARTE DHE ZHVILLIMIET DINAMIKE TE TIJ NE RRAFSHIN E INTEGRIMIT EUROPIAN

I Arsimi i Larte ne vendin tone, drejtimet dhe qellimi i tij

Arsimi i Larte ne vendin tone, pas viteve 90-te dhe ne vijim, ka ecur ne rrugen e transformimeve demokratike me te mirat dhe veshtiresite qe kane buruar nga zhvillimet e vullstme sociale, politike dhe ligjore te shogerise se sotme shqiptare.

Pas kalimit te veshtire te "rrjedhjes se trurit", per arsye ekonomike, dhe pas nje renie te pergjithshme ne veprimtarine universitare, arsimi i yne i larte dhe shkollat e larta te vendit tone filluan pak nga pak te rimekmben, te reformojne planet dhe programet mesimore, duke pemiuresuar legjislacionin dhe duke e pershtatur ate sipas standardeve

europiane dhe me gjere.

Ne kete periudhe te ndryshimeve te medha demokratike ne vend, nje numer i madh kandidatesh vershuan te studiojne ne nivel universitar dhe pasuniversitar ne shume vende europiane ne Perendim e ne Lindje dhe kjo, natyrisht, mriti shpresat dhe besimin se tasme shkolla e larte do te mrite cilesine dhe stafin akademik, do te krijoje terren me te pershtatshem per diplomimin bashkekohor te te rinjve shqiptare.

"Deklarata e Bolonjes" ne qershor te vitit 1999, perfshire nenskrimin e kesaj Deklarate ne shtator 2003 nga Qeveria shqiptare, krijuan nje dinamike te re dhe nje zhvillim ne brendi dhe ne strukture akademike dhe administrative te procesit

mesimor e shkencor ne universitetet dhe shkollat e larta te vendit tone e konkretisht :

Shirja e studimeve ne Universitet ne dy cikle: cikli universitar dhe cikli pasuniversitar .

Mobiliteti i studenteve dhe stafeve akademike.

Njohja dhe ekuivalentimi i diplomave.

Vendosja e sistemit te pikeve te kreditit: ECTS.

Suplementi i diplomes.

Vleresimi i cilesise dhe i akreditimit te studimeve.

Pemiuresimi i dimensionit europian ne bashkepunimin e programeve te studimit,

Vijon në faqen 12

Vijon nga faqja 10

e kualifikimit ne shkalle vendi. Matura shtetereore do te sherbeje ne kete drejtim

Kerkesat per emerim/kualifikim te metejshe do te rbeshteten ne analizen se si ai do te zbatohet apo ka zbatuar udhezimet e sakta administrative, edukative dhe sherbime te mesimohenies ne skolle dhe institucione te tjera

Nuk do te kete personel te tepert te punesuar ne shkolla. Nese ka, ky personel do te vihet ne efektivitet me programe me synim sigurimin e efektivitetit ne procesin e kualifikimit.

Teknologjia moderne e kerkuar dhe e vendosur ne shkolla duhet te gjeje zbatim te plote dhe te perdoret efektivisht nga mesuesit per procesin e kualifikimit.

Zbatim rigoroz i ngarkeses javore te mesuesve.

Rrajtja e normave dhe limitet e numrit te mnesve ne shkolla dhe klasa.

Kualifikimi per kategori te tjera .

Kualifikimi i mesuesve, si pjesa me e rendesishme ne suksesin e nje strategjie, eshte domosdoshmerisht i ndertthurur me kualifikimin e kategorive te neposhme:

- Drejtore t/Administrato ret e shkollave, Inspektoret e DAR, Trajnuesit e mesuesve. Neila Connors, studiuese amerikane ka thene: "Administrato ret e mire jane si shefat e shquar te guzhines. Ata shpenzojne dhe organizojne kohën per te perqatitur , planifikuar , vizionuar per ate qka ata do te zbatojne. Gjate kesaj

kohë fokusi i tyre perqendrohet ne rezultatet dhe klientet. Ne menyre te vazhdueshme riparojne, rivleresojne planet dhe perpjekjet e tyre."

Kualifikimi ne nivelin lokal.

Pas hartimit dhe percaktimit te strategjise se kualifikimit, procesi kalon ne pjesen e dyte te tij, ne dimensionin lokal, i cili eshte po aq i rendesishem pasi zbaton aspektet e mesiperme duke dhene arrijtet dhe nevojat per ndryshim, keto ne baze te qob DAR. Ato duhet te kete nje autonomi te percaktuar dhe per kete jane hartuar dhe pershkrimet e punes se sektoreve te trajnimit ne DAR-eve nga strategjia e mesiperme. Por ende nuk kane marre zgjidhje disa pyetje si:

Cili eshte vendi i kualifikimit brenda ne skolle? Pjesa e kujt do te konsiderohet?

A duhet te kete kualifikim periodik ne DAR, kur dhe kush do t'ja jape te drejten? A do ta bleje DAR sherbimin ne QKTA dhe ta zbatohet ne zonen e saj?

Nese do te kete veprimtari te tilla, ne cfare periudhe kohore do te zhvillohen? Do te kete planifikime me shkepulte njejavore apo me te gjata a me te shkurtra nga procesi shkollor?

Si do te vepron per aplikimet per kualifikime personale te mesuesve? Cilat do te jene kriteret dhe kush i percakton?

Cila do te jete forma e certifikimit dhe akreditimit te ketyre kualifikimeve?

DAR-et do te konsiderohen si :

Qendra te trajnimit masiv te drejtuesve

dhe mesuesve ne nivel lokal permes inspektoreve dhe rrjetit te specialisteve lendre.

Qendra burimore qe rekomandojne dhe vene ne dispozicion materiale.

Qendra te perhapjes se pervojave se perparuar ne nivel mesuesish dhe skolle ne rreth.

Duke percaktuar se cilet elemente te kualifikimit mund te zbatohen ne qark, percaktohet edhe se si do te kryhet certifikimi dhe akreditimi i tyre.

Kurse shkolla do te jete:

Qender e shkrabimit te pervojave ne nivel gruplerdesh.

Qender trajnimi ne rreth per drejtime specifike (drejtim administrim, lende te vecanta, kroskurrikula etj)

Ndarja e sakte e pergjegjesive institucionale dhe funksionimi i strukturave kualifikuese do te ndihmoje ndjeshem ne pemiuresimin e situates dhe per rrjedhoje ne ngritjen e cilesise se arsimit, sidomos ne keto drejtime:

- Forcimi dhe pemiuresimi i funksioneve te QIKA-se, si koordinatorë dhe zbatuesë e politikës shtetereore te kualifikimit te vazhdueshem, sistematik dhe me pikesynime kombetare te mesuesve ne teresi.

- Gjetja e formave te reja te motivimit te mesuesve ne nivele te ndryshme duke marre ne konsiderate statusin profesional, pagën dhe lehtësirat qe duhet t'i krijohen kesaj shtrese intelektuale ne realizimin e misionit te tyre te edukimit te brezit te ri .

ARSIMI I LARTE DHE ZHVILLIMIET DINAMIKE TE TIJ NE RRAFSHIN E INTEGRIMIT EUROPIAN

Vijn nga faqja 11

te integritit te studimeve dhe te formimit e te kerkimit shkencor .

II. Legjislacioni

M enjehere pas nenshkrimimit te "Deklarates se Bolonjes" nga 29 vende pjesemarrrese europiane, qershor 1999, ne sistemin e arsimit te larte ne vendin tone kemi nje pergatitje intensive per te afruar vijimisht sistemin e arsimit te larte me standardet e universiteteve europiane dhe konkretisht :

Hartimi i Ligjit te ri Nr. 84 61 te "Arsimit te Larte ne Republiken e Shqiperise", 25 shkurt 1999 dhe i ndryshuar ne vitet ne vijim 2003, 2004.

Reformimi i statuteve dhe i Rregulloreve te studimeve ne Universitetet dhe shkollat e larta te vendit.

Zgjedhja e niveleve drejtuese te shkollave te larta nepermjet perzgjedhjeve nga departamenti deri ne senatin akademik, pa emerime politike. Rektoret dekreteshin nga Presidenti i Republikes.

Ne funksion te Ligjit te arsimit te Larte ne Republiken e Shqiperise, kane dale nje numer aktesh normative nga Qeveria shqiptare, VKM dhe Udhhezime dhe Urdhhera te Minsitrit te Arsimit dhe te Shkences, te cilat kane ndikuar ne zbatimin gjithnje e me kualitativ te "Procesit te Bolonjes" te shtrire ne vite akademike.

III Misioni i institucionit pergjegjes

Ministria e Arsimit dhe e Shkences, ne bashkepunim edhe me ministrite e tjera dhe shkollat e larta, ka sjelle aktualisht nje shtate te re te reformimit te sistemit te arsimit te larte dhe integritit te tij ne rrjetin e arsimit te larte europian e konkretisht :

- Reformimi i sistemit te studimeve ne dy cikle : universitar dhe pasuniversitar

- Reformimi i kurrikules ne te gjitha degjet dhe profilet e studimit dhe tasme 70 % e planeve dhe programeve jane te njejta. Ne kete menyre, behet i mundur transferimi i studimeve nga njera skolle e larte ne tjetren, brenda sistemit tone arsimor dhe jashte sistemit tone arsimor .

- Pas nenshkrimimit te "Deklarates se Bolonjes" shtator 2003 ne Berlin nga Qeveria Shqiptare, mori nje zhvillim te madh reformimi ne Arsimin e Larte e

konkretisht :

-Reformimi ne strukturen e studimeve : 3+2+3, 4+1+3 dhe 3+1

- Reremuesimi i legjislacionit te arsimit te larte: korrik 2003, 2004

-Shtrirja e studimeve ne tre nivele dhe me pas ne 4 nivele : Bachelor , master , doktorate dhe te mesuarit gjate gjithnje jetes.

-Vleresimi i brendshem dhe i jashtem i cilesise ne stafe akademike, ne mesim-dhene, ne teknologji informacioni dhe literature shkencore, artistike dhe psiko-pedagogjike.

- Reformimi i sistemit te pranimeve ne shkollat e larta nepermjet "Matures Shtetore" ne vitin e ri akademik 2006-2007.

IV. Komiza e kualifikimeve, strategjia kombetare per reformimin e arsimit te larte.

Universitetet dhe Shkollat e Larta ne Shqiperi jane perfshire ne nje reformim dhe ristrukurim per zbatimin e "Deklarates se Bolonjes". Ne fokus te saj eshte pergatitja profesionale dhe shkencore e studenteve ne te dy nivelet : universitar dhe pasuni-versitar .

Ne Arsimin e Larte ne Shqiperi behet nje pune sistematike, me programe te qarta dhe bashkekohore per te pergatitur studente te afte per te punuar ne sektore te ndryshem te Ekonomise se Tregut. Konkretisht jane pasuruar te gjitha kurrikulat, jane hapur degjet dhe profilet te reja te studimit, jane perafruar programet me ato te vendeve te zhvilluara te Europes, SHBA, etj.

Ministria e Arsimit dhe Shkences ka marre masat e nevojshme edhe per nje pergatitje shkencore bashkekohore te stafit akademik. Jane te shente pedagogjet shqiptare qe kane kryer kurse dhe specializime ne shume universitete te Europes, ne SHBA e deri ne Japoni. Keto natyrisht kane sjelle nje pervoje te ndryshme dhe kane krijuar hapesira te reja per nje pergatitje me profesionale te studenteve, te diplomimit te tyre cilesor dhe me te gatshem per te perballuar sfidat e kohes dhe te Ekonomise se Tregut te Punes.

Gjithashtu jane krijuar kushte dhe mundesi qe procesi i kualifikimit te pedagogjeve te behet edhe ne Shqiperi. Si

rezultat, eshte nritur numri i pedagogjeve me kualifikim te larte shkencor pasuniversitar ne Tirane dhe ne rrethe. Kjo dukuri ka sjelle edhe nje proces mesimor me te zhvilluar, me modern dhe ka ndikuar drejtpersdrejti ne formimin profesional te studenteve, te cilet do te dine te orientohen me mire ne tregun e ri te punes dhe do te luajne nje rol me aktiv ne zhvillimin e Ekonomise se Tregut.

Vlen te pemedet edhe infrastruktura e teknologjite e reja te informacionit, te komunikimit dhe te kerkimit shkencor, tedilat kohet e fundit ne Universitetet dhe Shkollat e Larta te vendit tone kane ardhur duke u pasuruar .Ato kane krijuar mundesi me te mira per dinamikën mesimore shkencore dhe sigurisht nje avantazh ne pergatitjen profesionale te studenteve.

Pjesemarrja ne projekte te stafit universitar ne bashkepunim me TEMPUSIN, SCROS etj. ka krijuar ,gjithashtu, mundesi me te mira per nje pergatitje me akademike dhe profesionale, si te pedagogjeve ashtu edhe te studenteve ne vendin tone.

Ne funksion te lidhjes se shkolles me jeten, te Universitetit me Ekonomine e Tregut, ne bashkepunim me Bashkimin Europian dhe Keshillin e Europes, jane organizuar seminare nderkombetare me pjesemarrje te gjere nga kontinenti europian, per te shkenbyer pervojen dhe per te organizuar ne mire vegrintarine polivalente ne Universitete dhe Shkolla te Larta ne te pergatitjes profesionale te studenteve, te zhvillimit te tyre cilesor ne rrafshin te ndryshme te shkencave, por sidomos ato me karakter ekonomik dhe inzhinierik, te praktikave mesimore, te pjesemarrjes direkte ne biznese te ndryshme etj. Kjo po shogerohet dhe duhet te shogerohet me mire me nje programacion ne sherbim te tregut, te nevojave te tij dhe te prirjeve moderne te tij ne nje bote ku teknologjite dhe informacioni zhvillohen me shpejtesi.

Eshte e natyrisht qe ende ka shume pune dhe pergatitje shkencore qe MASH, trupat akademike dhe te studentet duhet te bejne per te zbatuar kerkesat e procesit te Bolonjes. Por ajo cka eshte arritur perben nje baze te qendrueshme dhe inkurajuese per te ecur me me shpejtesi perpara.

Prof. Asoc. Dr.Valier Peshkopia,
Arsimi i Larte, MASH

U mbl odh Aktivi i SPA QArkUt tirAne

Keto dite u mbajt aktivi i zgjeruar i Sindikates se Pavarur te Arsimit te Qarkut Tirane.

Ne aktiv moren pjese edhe kryetari i SPASH-t, Zoti Bajram Kruja, Presidenti i SP te Prefektures Tirane Z. Gani Lami dhe nen/kryetari i SPASH-it z. Defrim Spahiu.

Perpjekjet e muajve te fundit per shtrirjen e sindikates ne sa me shume shkolla, ndihmesa qe kane dhene individe te caktuar, kane dhene rezultatet e veta, gje qe reflektohet ne shtrirjen e aktivitetit sindikalist ne rreth 40 shkolla.

Ne aktiv u percaktuan edhe dobjektivat

vendimeve te forumeve me te larta te SPASH-it,

- Zbatimin e te drejtave ne marredheniet e punes sindikalist-drejtor,
- Hartimi dhe nenshkrimi i kontrates kolektive te nivelit te dyte,
- Sigurimi i fondeve per financimin e kurseve kualifikuese.

Aktivin e pershendeti edhe Z. Bajram Kruja, i cili theksoi domosdoshmerine e krijimit te nje partneriteti efektiv drejtor-sindikate, per zgjidhjen e problemeve te ndryshme qe hasen ne pune. Nderkohe, Z. Defrim Spahiu u ndale tek arsyet pse nuk ka patur nje organizim rezultativ ne te kaluaren te SPA, Qarku Tirane. Ai vleresoi punen e kryer nga Z. Shaban Duka dhe vuri ne dukje dobjektivat e pergjithshme te SPASH-it.

Z. Gani Lami pershendeti Aktivin dhe falenderoi per ftesen. Znj. Reihan Shkreta, kryetare e SPA, qyteti Tirane denoi qendrimin negativ te ish-drejtorit te DAP per pergimin e punes se sindikates.

Nder problemet e ngritura nga pjesemeresit ishin:

- Perballimi i uhetitimit te mesuesve dhe te nxenesve,
- Transparenca e perdorimit te fondeve te dhena per shkollat.

Ne fund te aktivit u bene zgjedhjet per kryetarin dhe kryesine te perbere prej nente vetash. Kryetar u zgjodh Z. Shaban Duka.

Vern ALLDERVISHI
Pergjegjes i Rinise, SPA Qarku Tirane



Raportin mbi punen e bere dhe detyrat per te ardhmen e mbajti Z. Shaban Duka, i cili analizoi punen e bere dhe problemet e hasura per fuqizimin e sindikates, kontributin qe ka dhene kjo sindikate per mbrojtjen e interesave te mesuesve, sidomos per plotesimin e kerkesave te tyre per rritjen e pages, uljen e moshes se pensionit dhe mbrojtjen e te drejtave te mesuesve.

per te ardhmen, midis et cilave mund te pemendim:

- Shtrirja e sindikates ne te gjitha shkollat e rrethit Tirane,
- Krijimi i seksioneve sindikale ne shkolla dhe ne nivele lokale,
- Nje pune e organizuar ne drejtim te rritjes se mireqenies se mesuesve edhe me veprimet sindikale, po te jete e nevojshme,
- Moshetet je dhe qendrim besnik ndaj

KUR VITI ARSIMOR SHKON DREJT PERFUNDIMIT

Ne shkollen 9-vjeçare "7 Marsi"-Tirane

1.

Drejtoresha e shkolles 9-vjeçare "7 Marsi" ne kryeqytet, znj. Liljana Kaimi, e çlitar, energjike dhe e perkushtuar, nuk di se çfare te tregojte me pare per kolektivin e mesuesve dhe te nxenesve. Pasi pemend emrat e kolegeve drejtuese, Lida Isufi, Fatbardha Martini e Dhurata Hoxha, nder te tjera, ajo nenvizon: "Se bashku me stafin pedagogjik, perpiqemi per ta naxtur dhe çuar ne perpara traditen e shkolles sone, duke krijuar nje imazh sa me te mire ne komunitet. Po synojme qe ajo te rrezatoje ne tere veprimtarine e saj mesimore-edukative, duke siguruar nje klime bashkepunimi e respekti ndaj mesuesve,

nxenesve e prinderve, si partneret me te afert. Po kaq rendesi po i kushtohet motivimit te nxenesve, si dhe nxitjes se mendimit te lire e krijues te tyre".

Pastaj ajo na ve perpara disa plane e projekte te vitit arsimor 2005-2006. Edohe pemmes tyre, kupton se si po punchet ketu per te arditur synimin kryesor te kolektivit mesues-nxenes: "Pemuqesimin e cilesise se sherbimit arsimor ne sistetmin parauniversitar", duke zbatuar detyrat e D A te Tiranes dhe Ministrise se Arsimit e Shkences.

Jo vetem ne leter, por dhe ne praktiken e perditsme, mesues, nxenes e prinder jane njohur me gjendjen baze te shkolles.

Keshtu, nder te tjera, mesojme se ne ciklin e ulet vijojne 385 nxenes dhe ne ciklin e larte 518 nxenes, te cileve u japin mesim afer 41 mesues te perhershëm, pothuajse te gjithë me arsim te larte. Te vetedijshëm per arditjet dhe problemet qe dalin, jane percaktuar "pikat e forta" dhe "pikat e dobeta" te veprimtarise se perditsme. Ne te parat, pemenden: tradita e vyer e shkolles, me staf profesionistesh; departamentet, si qeliza baze te punes kualifikuese; ngritja e laboratoreve dhe e bibliotekes; lidhjet me komunitetin-te kenaqshme; infrastruktura-me tregues

KUR VITI ARSIMOR SHKON DREJT PERFUNDIMIT

normale. Ndërsa për të dytat janë evidentuar: kontingjenti i nxënësve-heterogjen; monitorimi i orëve edukative nga drejtorja dhe komuniteti; mjediset mesimore-te kufizuara, duke u zhvilluar mesimi i CU pasdite; komuniteti-me mundësi të pakta për të ndihmuar shkollën.

Kur bisedon me mesues, nxënës e prinder, por dhe kur viziton klasat e kabinetet (po ngrihen tre të tilla për shkencat dhe një për gjuhën angleze) e kur sheh korridorët e mbushur me stenda të bukura e funksionale, krijon përshtypjen se këtu ka mobilizim dhe punët shkojnë gjithnjë e më mirë. Por, njëkohësisht, vëren dhe se ka kërkesa në rritje për t'i qar ato me përpara, pra pa rënë në vetëkënaqësi. Si baze në këtë drejtim është vlerësuar përvoja e përparuar, e cilat përsëriten dita-ditës, me anë të sistemit të kualifikimit. Dobitërisht është dhe mbështetja e stafit

tyre për ta mbyllur atë me sukses. Një vit me parë u arrit kalueshmëria 98 për qind dhe nota mesatare 7.8. Por tani, me të drejte, këtu synohet për më shumë. Mesuesit bëjnë përsëritje dhe sitemim njohurishë, për të mbushur ndonjë boshllëk të krijuar dhe po e kushtojnë vëmendjen me tepër të nxënësit me prapambetje.

Po kështu, kujdes i veçantë tregohet për nxënësit e kësaj klaseve të teta, që se shpejti japin provime. Janë ngritur kënde të posaçme, me ta janë zërtëruar pyetjet dhe është folur për rëndësinë e lëndëve që kanë provim etj. Bile, edhe gazeta mujore e shkollës, me emrin frymëzues "Arome marsi", (kryeredaktore nxënësja Elona Xhafa), numri i parë i se ciles doli në janar 2006, është vënë në ndihmë të kësaj pune. Kështu, ajo ka botuar rubrikën "Si të mesosh për provimet e fundit", duke dhënë udhëzime praktike për të interesuarit.

edhe mos të ketë braktisje të mesimit as të shkollës. Objektivit kryesor në këtë fushë është: "Të edukojnë të nxënësit ndjenjen e atdhedashurisë, kërenarise kombëtare, respektit për trashëgiminë lokale, kombëtare e botërore". Ndër synimet e tjera, janë përcaktuar: ndërgjegjesimi i nxënësve për të drejtat e tyre, njëhja dhe respektimi i ligjit, edukimi i dashurisë për librin dhe leximin etj.

Në shkollën 9-vjeçare "7 Marsi" të kryeqytetit zhvillohet një jetë e gjallë kulturore-artistike dhe fizikurore-sportive. Ashtu si për tërë procesin mesimor-edukativ, në këtë drejtim po jep ndihmesën e saj edhe sindikata e arsimit, që drejtohet nga mesuesi Vehap Xhafa. Ata kanë qenë bashkëpunëtorë aktivë dhe mbështetës të drejtorisë për veprimtaritë e zhvilluara me rastin e festave të Nëntorit, për Vitin e Ri, Ditën e Mesuesit, Festën e Abetares, 1 Qershorin etj. Se bashku janë kujdesur edhe për t'u ardhur në ndihmë femijëve jetimë e në nevojë. Tani po bëhen përgatitje për veprimtaritë e shfaqjet, që do të organizohen me rastin e mbylljes së vitit arsimor.

Një drejtim i veçantë i punës së sindikates së arsimit, është kujdesi për jetën e anëtarëve të saj. Përveç vizitave me raste gezimesh ose ngjarjesh tjera të shënuara, janë organizuar ceremoni për daljen në pension të anëtarëve të kolektivit pedagogjik. Përmendim këtu edhe përcjelljen e mesuesëve të palodhura të kësaj shkolle, Mereme Toska e Tatjana Hajraj. Ato kanë shprehur dëshirën që të takohen përsëri me anëtarë të kolektivit, në muajin qershor, që shënon dhe rikthimin e këtij viti shkollor.

...Kur po e perfundonim bisedën me drejtoreshën L.Kaimi, ajo shprehur dëshirën që të shënonim dhe mbështetjen e treguar ndaj kësaj shkolle nga bordi i saj, me kryetar z. Bashkim Haxhiu. Ky ka dhënë shembullin vetjak, duke përballuar zbulimin e mjedisve të ndryshme. Ndërsa z. Ali Selmani ka vendosur tërë sistemin e fonisë. Por nuk ka munguar dhe ndihma modeste nga prinder të ndryshëm.

Këto dite të fundit të mbylljes së vitit arsimor, të gjithë i gjetëm të përkushtuar në shkollën "7 Marsi" të Tiranës. Prandaj shprejtojmë e besojmë që nxënësit e të gjitha klasave të arrijnë përfundim sa me të larta, ashtu si dhe ata që kanë provime.



drejtues në punën e bordit, keshillit të mesuesëve dhe departamenteve lëndore, keshillit të prindërve, qeverisë së nxënësve (kryetare Solora Jaupaj), grupit të edukimit etj. Të vjen mirë, kur degjën për veprimtarinë e frytshme të drejtuesve të departamenteve: Merita Shkreli (gjuhë-lexim), Aferdita Mersinllari (kimi-biologji), Alida Qershori (matematike-fizike) Vehap Xhafa (histori-gjeografi) dhe Shyqyri Lazimi (edukim muzikor dhe edukim figurativ). Por meritojnë të përmenden dhe mjaft mesues të pasionuar, si ata të lëndës së matematikës, Kostandin Leka e Vladimir Kokeri.

2

Ky vit arsimor po shkon drejt përfundimit. Kjo i ka vënë në pozitë me të larta punë mesuesit e nxënësit dhe, bashkë me ta, prinderit që të shtohen përpjekjet e

3

Ditën, që u rikthim në këtë shkolle, mesues e nxënës po niseshin për një vizitë në Fabrikën "Coca-Cola", në autostradë. Se për ekskursionet mesimore dhe njohjen e vendlindjes tregohet kujdes i vazhdueshëm. Kështu, grupe nxënësish kanë vizituar qytete të ndryshme të Shqipërisë, si Shkodrën, Lezhën, Krujën, Pogradecin etj. Në këto udhëtime nxënësit kanë parë lukurite e natyrës sonë, por dhe kanë marrë njohuri gjeografike, historike, arkeologjike etj., duke i shërbyer kjo, në përgjithësi, edukimit atdhetar të tyre. Janë bërë edhe përgatitjet paraprake për t'u binjakzuar me shkollën simotër "7 Marsi" të Prishtinës, me kolektivin e se ciles parashikohen vizita të ndërsjella dhe veprimtari të përbashkëta.

Përparesi po i jepet punës edukative, në shkolle e jashtë saj. Kjo ka ndikuar që

Të reja shkencore

ULU NUVO, ULU

U merzitet duke ndenjtur vetem ne shtepi çdo mbremje? Blini Nuvon. Ky robot 15 inch i gjate, me dy kembë, mund te kercejte, flase, te luaje muzike, te tregojte oren dhe madje



edhe te te shtrengoje doren. Ai mund t'u pergjigjet 40 komandave te thjeshta (si Nuvo, eja te kercejme) me nje ze qe perdor nje theks japonez dhe, gjithashtu, te beje foto duke perdorur lentet Ciklop te montuara ne koke. 15 kyçet e motorizuara ne trupin e tij bejne te mundur qe Nuvo te beje manovra te ndryshme me koke si edhe te shetise i lire ne shtepi. Nuvo mund edhe te shkarkoje

fotografite tuaja ne celular. Qe ta beni te tuajin, per momentin duhet te shpenzoni nje vlere minimale prej 7 000 dollaresh.

RIVENDOSJA E UJIT TE PASTER

Me çmimin e nje kafeje me qumesht, rreth 3 dollare, mund te shpetohet vertet nje jete.



Lifestraw, pipzi i krijuar nga kompania me baze ne Zvicer, Vestergaard, perdor shtate tipe filtrash, duke perfshire karbonin aktiv dhe jodin per te bere 185 galon uje te paster. Ai mund te parandaloje semundjet qe transmetohen nepermjet ujit si tifoidin dhe diarene, qe bejne qe te vdesin te pakten 2

milion njerëz çdo vit ne vendet ne zhvillim. Ai mund te siguroje uje te pijshem edhe per viktimat e termeteve, tufaneve dhe fatkeqesive te tjera.

PASTRUESI SCOOPA

Scooba, fshesa robotike, ne çdo hap kryen kater operacione pastrimi: fshin therrimet, leshon nje solucion pastrues te veçante Clorex ne dysheme, pastron siperfaqen me nje furçe dhe, me pas kthehet, ne nje pastruese me korent per te thithur ujin e piste. Ajo eshte ne gjendje te kaloje pengesat



dhe ka nje sensor "shkemb" qe parandalon nje renie te mundshme nga shkallet. Ajo kushton vetem 400 dollare.

Keshilla praktike

DHJETE MENYRA PER T'U NGRITUR NE DETYRE

Te lane menjane perseri? Gradimet nuk bazohen gjithmone ne merite. Ju mund te jeni punonjesi me me eksperience, me i kualifikuari ose me punetori, por shpesh jane faktore te tjere ne loje, gjera si imazhi, lidhjet, politika e zyles dhe fati.

Ja ku jane 10 menyra per te rritur mundesite per te ngjitur shkallet e suksesit.

1. JINI KOMPETENT

Zoteroni mire punen tuaj aktuale dhe shtrini njohurite dhe aftesite tuaja ne fusha qe i interesojne organizates suaj. Kurre mos e harxhoni nje mundesi trajnimi. Nese jeni i interesuar per nje pozicion te caktuar brenda kompanise suaj, gjeni gjithçka mundni per punen qe deshironi. Keshtu ju mund te identifikoni dhe te plotesoni ndonje boshllëk njohurie qe mund te keni dhe ta poziciononi veten si trashgimtari i ardhshem me i pershtatshem.

2. KRIJONI LIDHJE ME SHEFIN TUAJ

Shefi juaj eshte portieri midis jush dhe pozicionit tuaj te ardhshem ne kompani. Kujdesu per kete marredhenie duke krijuar raporte dhe duke treguar qe i keni perzemer interesat e tij. Uluni shpesh me shefin tuaj per te zbuluar cilat jane nevojat e tij dhe si mund te ndihmoni per t'i realizuar.

3. KRIJONI RRJETIN TUAJ

Krijoni kontakte dhe marredhenie kudo ne

kompani duke dale vullnetar per te sherbyer ne stafe brenda departamentit tuaj ose per te ndihmuar sektore te tjere. Bashkohu me skuadren e futbollit te kompanise suaj ose nje aktivitet tjeter ku mund te shndrisni. Planifikoni te hani dreke me nje koleq te ri te pakten nje here ne jave.

4. TE DINI SE SA VLENI

Mbani shenime te arritjeve dhe kontributeve tuaja ne organizate duke llogaritur rezultatet, kur eshte e mundur. Krijoni nje dosje ne pune qe te nxirrni ne pah aftesite dhe eksperiencat tuaja. Kjo jo vetem qe do t'iu kujtoj sa te mire jeni, por do t'ua beje te ditur kete edhe te tjereve.

5. HIQNI DORE NGA NERVOZIZMAT

Shume drejtues dhe njerëz te tjere te sukseshem i bejne te tjeret te ndjehen mire. Sigurohuni qe te harxhoni energji positive per te degjuar dhe inkurajuar te tjeret. Mos u qani dhe mos u ankoni kurre. Beni te pamunduren per t'i bere gjerat ne menyre konstruktive dhe praktike.

6. BENI TE MUNDUR QE TE VIHENI RE

Fitoni vemendjen e te tjereve duke dale vullnetar per pune qe mund te keni ne televizione apo gazeta. Ofrohuni per te folur ne takimet e kompanise. Shkruani artikuj ne gazeten e kompanise per arritet tuaja dhe te stafit tuaj. Shikoni mundesite per te njohur shoket e shefit tuaj, eporet dhe te tjere ne strukturen e kompanise.

7. VISHUNI SIPAS POZICIONIT

Nese doni te beheni zevendes drejtor i shitjeve, eshte mire te dukeni si i tille. Vishuni dhe silluni ne nje menyre qe te ngjalle besueshmeri te ata qe ju rrethojne.

8. KRIJONI MUNDESI PER VETEN TUAJ

Njehesoni ambiciet tuaja me ato te kompanise dhe me nevojat e departamentit. Shihni tendencat e tregut dhe vleresoni nevojat dhe sfidat e kompanise suaj. Nese shihni nje fushë qe po neglizhohet, krijoni mundesite per veten tuaj duke shkruar nje propozim te ri pune dhe duke e pershkruar ate.

9. KINI DURIM

Shume punonjes, (sidomos te rinjte), nuk rrine ne nje kompani aq sa duhet per te perparuar. Mbani mend, doreheqja e nje kolegu mund te nenkuptoje ngritjen tuaj ne detyre, prandaj qendroni aty dhe mbajini syte te çmimi.

10. JINI NE VENDIN E DUHUR NE KOHEN E DUHUR

Sigurisht, nese shefi juaj nuk ju admiron dhe kompania eshte gati te shkrihet, shanset per gradim jane shume te vogla. Jini realist. Vendoseni veten ne siuate ku sukcesi eshte me shume i mundshem. Gjeneroni nje kompani me njerëz qe ju pelqejne, qe vleresojne aftesite tuaja dhe qe pershtaten me stilin dhe parimet tuaja.

Përgatiti faqen Eriona Vangjeli

Tribuna sindikale

